Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana 15-01-2024 vit.god. | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 01 | 060 | 01- | 67 |

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të Nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011; Nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

# F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **I** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **19.01.2024 (e Premte),** në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në Zyrën e Konferencave në objektit e vjeter të komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## R e n d  d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e njëmbëdhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2024.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacioneve për vendosjen e bizneseve në Parkun Industrial në Budrik të Epërme.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Planit të Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2024.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale me pronat e paluajtshme ne pronësi te pronareve Kadri (Bislim) Emerllahu dhe Agron (Ahmet) Ahmeti.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shfuqizimin e vendimit për miratimin e Planit të Integritetit 2023-2026 të Komunës se Vitisë, vendimi me nr. 01-110/05-163, i datës 01-03-2023.**
7. **Informatë mbi punën e kuvendit komunal dhe komiteteve funksionale për periudhën Janar - Dhjetor 2023.**
8. **Informatë mbi punën e komitetit për komunitete të komunës së Vitisë për periudhën Janar - Dhjetor 2023.**
9. **Informatë për zbatimin e planit te KKSB-së për vitin 2023.**

**Viti, më 15.01.2024**

**Me respekt!**
**Kryesuesi i Kuvendit**
**Bekim Azizi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
KUVENDI KOMUNËS - SKUPŠTINA OPŠTINE

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROCESVERBAL

## NGA MBLEDHJA E NJËMBDHJET E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi, z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **18.12.2023 (e hënë)** në zyrën e kryesuesit të Kuvendit Komunal, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Ilir Zuka, z.Ramadan Deliu, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, znj.Zejnepe Osmani, znj.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për të githë të pranishmit! Faleminderit që ju keni përgjigj ftesës mbledhja e fundit për këtë vit. Ju falemenderoj për bashkëpunimin e juaj. Të nderuar anëtarë të komitetit, të gjithë të pranishmit që jeni në këtë takim, materilian e keni marrë me kohë, ndërsa pjesa e konfirmimeve të ligjshmërisë nuk ka pas ndonjë ndryshim prej seancës së fundit. Para se të hymë në rend të ditës, unë e kisha hap diskutimin, por fillimish e kam një kërkesë për nënkryetarin. Nënkryetar, janë tu mbjell do dru dekorativ në rrugët e Vitisë, tu kisha lutur që ti mbjellin edhe do rrugës së Smirës, sepse janë të mbjellura aty nja 200 bimë, po me shku me i mbjell edhe nja 30 copa, sepse janë të dëmtuara aty. Pasi që nuk ka për diskutim, kalojmë tek rendi i ditës.

### Rend dite

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës se veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për periudhën në shfrytëzim gjatë vitit 2024.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të Vendimit me Nr.01-110/05-1311, të datës 30.10.2023 për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës Kompanisë Kovare për Distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a (KEDS) në Viti për vendosjen e trafove elektrike.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës së Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2024.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e punës së komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave në fshatin Devajë të Komunës së Vitisë.**
6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031 të Komunës së Vitisë.**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi diskutimin me këto pikat që i prezantum. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim rendin e ditës. Nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim miratohet rendi i dites.

Si pikë e parë e rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dhjetë e Komitetit për Politikë dhe Financa**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për procesverbal. Pasi që nuk ka, a jeni me ngritje të dorës që të miratohet. Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet.

Si pikë e dytë e rendit të ditës:

**2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e listës se veçantë të pronave të paluajtshme të komunës, që planifikohen për periudhën në shfrytëzim gjate vitit 2024**

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Matrialin e keni pranuar me kohë, po kemi një kërkesë që t'i shtojmë edhe dy prona tjera. Tani ja prezentova kryesuesit fletat poseduese. Për pyetje shtesë, urdhëroni.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka për diskutim, qes në votim për miratim. Nga të gjith të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e tretë e rendit të ditës:

**3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim-plotësim të Vendimit me Nr.01-110/05-1311, të datës 30.10.2023 për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe furnizim me energji elektrike sh.a (KEDS) në Viti për vendosjen e trafove elektrike**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Në seancën e kalume e kemi miratu nje vendim per dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës kompanisë KEDS. Po kanë qenë tri parcela që e kanë pas numrin e fletës me gabime, e për këtë duhet me bë ndryshim plotësim. Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjith të pranishmit u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e katërt e rendit të ditës:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për planin e punës së Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Vitisë për vitin 2024**

Komitetit per Komunitete është komitet obligativ i formuar prej Kuvendit, e ka përgaditë planin e punës për vitin 2024. Materialin e keni me veti. Hapi debat për këtë pikë të rendit të dites. Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë e pestë e rendit të ditës:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e punës së komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave në fshatin Devajë të Komunës së Vitisë**

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Komisioni e ka kry punën e vet dhe para juve e ka paraqitë materialin për miratim të raportit të punës së tyre. Komisioni ka qenë i formuar nga Kuvendi.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Fjala është për në Devajë. Ne e kemi pas afatshkurtë, tani e kemi bë afatgjatë, nuk e kemi caktu kohën dhe po e shof që komisioni që është formua nga Kuvendi e ka bë një raport i cili e ka me plan të biznesit. Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

**z.Ilir Zuka:** Me sa e pash unë shumë punë të mira po planifikojshin mu bë. Ishin nda 60 euro për hektar për vjetore mu pagu. Na e kemi 99 hektar, dikun vlera mbi 6000 euro ish ne vit. Punë e mirë i kish nda fushat e investimeve solare, pemëtari, blegtari. Nuk më pëlqej qekjo e fundit, po besoj që komisioni në fund e hek ku është të tjera, sepse nuk diet se çka. Përndryshe si matrial që e kish bë ai, unë nuk jam pishman që e kam votu edhe kush e man përgjegjësinë nëse nuk i rrin gati ky me e pagu.

**z.Jakup Demiri:** Kush janë anëtarët e komisionit këtu.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Nëse nuk gaboj është Durimi, Zejnepi nga Kuvendi, nga ekzekutivi Kemajl Frangu, Albulena edhe një nga shoqëria civile.

**znj.Liridona Bislimi:** Mos ka qenë mirë me e pas një biografi të personi i cili është tu e bë një investim.

**z.Ilir Zuka:** E ki në material, e ka cek sa ka pasuri e vet e ka cek në aplikacion.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Unë personalish nuk e njoh, po duket me qenë serioz, sepse e ka bë një investim të madh në Prishtinë, ky e ka pru taksisti Tesla.

**z.Jakup Demiri:** Unë mendoj që duhet me pas kujdes kur të ndajm pasurin e komunës, se janë do ligje

ndërkombëtare ku thuhet se dikush që e zotron një pronë mbi 25 vite [illegible]
shtete ligji ja mundëson, se nëse shteti nuk e shfrytëzon atë pronë, i takon atij. E për qata po thamë që s'a mirë me dhanë në shfrytëzim mbi 25 vite kuvendet komunale.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Ligji ja njef disa benificione, po edhe e dënon për diçka nëse ai është i përgjegjshëm dhe punon konform ligjit dhe kontratës që e nënshkruan nga komisioni dhe duhet t'i pergjigjet kontratës.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Përshendetje të nderuar të pranishëm! Këtu po shof që paska me investu tek panelet solare, e këto nuk janë të parapamë, e për këto nuk mundet me e marr pëlqimin ai nga komuna për këtë, e nga ministria s'un e merr lejen pa pëlqimin tonë, e tani duhet me fol me ata ose me e hek këtë nga plani i tij ose me e shiku mundësinë ne kur t'i bëjmë hartat zonale, sepse ligji e ka lan një mundësi që, komunat që parashohin potencial me energji, rrymë të përtritshme, mu fut pa PZHK, mu bë si plotësim edhe pse s'a e parapamë në PZHK. E tash për tash si është problemi, komisioni ka qenë dashtë me parapa se çka lejohet në atë pjesë. Unë i kisha lan panelet solare me mundësi.

**z.Jakup Demiri:** Edhe unë kesh tu pyet për qeto puna e paneleve solare. Na nuk e dimë se si ka me qenë puna aty.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Çështja e paneleve solare 30 kilovat nuk është shumë që shifet, po është për çështje të veta, është për me punu që i duhen atij aty.

**znj.Liridona Bilaimi:** Ne e dimë çfarë toke, çfarë vlere e ka kjo toka në Devajë.

**z.Ilir Zuka:** Unë e ceka me herët ata çka pata me thanë, po po ndërlidhem me Visarin. Është mirë me cek me mundësi edhe për panelet solare.

**z.Ramadan Deliu:** E pra plani i biznesit i paska konkretizu gjërat. Unë mendoj që duhet me e votu.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** E tha nënkryetari, në kontratë duhe mu precizu, sepse këtu nuk po e shof se cilat vite ka me i mill arat e cilën ato. Mendoj që duhet mu specifiku në kontratë. P.sh.: me tha që brenda tri vite duhet mu mbill arrat e lejthiat për këto 60 hekter, se nëse nuk i bënë këtë brenda viteve, për këtë duhet mu cek.

**znj.Liridona Bislimi:** Mos ka qenë më mirë me e shty e me ditë na se çka po votojmë, me qenë më mirë të informuar ne, sepse e dimë rëndësinë e asaj toke, sepse kanë qenë edhe eksper me herët që e kanë vizitu atë tokë dhe kanë thanë që ka disa elemente shumë të veçanta të cilat nuk mundemi me i gjetë ndoshta me asnjë shtet fqinjë. Mos ka qenë mirë me e shty, sepse e di unë që ka pas shumë të interesume. Më kanë pyet edhe mu edhe familjarët për këtë vend.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Liridonë, nuk po muj mu pajtu me këtë, sepse ka qenë ankandi publik bre. E kanë pa të gjithë secili ka mujt me apliku, kërkush nuk i ka ndal që me apliku, ka qenë njoftimi.

**z.Jakup Demiri:** Ka pas të intersum, ka qenë një i Remnikut po të cilin në start e keni eleminu.

**z.Ilir Zuka:** Gjatë kohës sa ka qenë njoftimi, d.m.th koha që ka qenë për me apliku edhe tek unë u afru një kompani me ka pyet, edhe ata janë të Remnikut, jetojnë në Zvicerr, edhe ata e kanë pas qëllim per ndërtim për solare. Po unë ju kam thanë se, se di a banë për solare, i kam tregu edhe ai nuk ka konkuru edhe unë mendoj që duhet me cek në vendim se, kur duhet me i fillu punët.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë sinqerisht nuk e njof këtë, as nuk kam bisedu me ta. Unë mendoj që ku është ajo e mirë që me pas investimeve serioze. P.sh: në komuna tjera komuna i thirr vet me investu edhe unë po thamë se duhet me ju mundësu që me invesitu. Ne duhet me qenë të kujdesshëm ne investitor, se e dimë që Vitia ka mbetë në perifreri dhe çdo here ka me shku tu humb vlerën ne vetëm mënyrën e njëjtë tu bë investimet, mundemi me shtu vlerën.

**z.Fatlum Demiri, sekretari i kuvendit:** Vendimi i Kuvendit i dates 30.06.2022, neni 2, afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale është afatshkurtë, prej 15 vite, që në një vendim ne më vonë e kemi bërë afatgjatë me kultivimin e kulturave bujqësore, me qëllim të shfrytëzimit nga ana e perosnave fizik apo juridik. Caktimi i afatit kohor për ndëritmin duhet të jetë brenda 1 viti, duhet të filloj projekti pasi të shpallet fituesi. Ky vendim është i Kuvendit.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ai fillon i mbjell 2 hektar arra dhe i lenë 96 hektar.

**z.Fatlum Demiri, sekretari i kuvendit:** Kjo specifikohet kur të bëhet marrëveshja, kontrata sa pare ka me investu në vitin 2025, 2026, për sa e realizon projektin. Unë nuk e kam lexu detajisht planin, por brenda kontratës që bëhet marrëveshja duhet me u cekë këto gjëra. Sa i përket vendimit të Kuvendit, Liridona vetëm që po mungojka komisioni që nuk ju ka bashkëngjitë këto dosje, se për ndryshe në webfaqe është.

**z.Ilir Zuka:** Prapë në fund kur ta nxjerrim ne këtë vendim unë kisha kërku me u cekë përsëri këto.

z.Fatmir Demiri, sekretari i Kuvendit: ... ndryshimi plotësimi ...
afatshkurtë në afatgjatë, vetëm këtu është ndryshimi. Ju sot jeni tu diskutu me miratu vetëm raportin e punës së komisionit. Marrëveshja, kontrata që nënshkruhet ajo është procedurë tjetër.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Në Kuvend mundesh me kjarëtsu kështu shumë bukur e definum që me fillu me 1 vit. Duhet me i parapa ai për me i shti 1 milion e 448 mijë. Tani sa e shef mbyllja e projektit.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë mendoj që duhet përcaktohet në periudhën brenda vitit fillojnë, brenda 5 viteve të përfundojn investimet. Pasi që nuk ka më për debat, a jeni që kjo pikë të shkoj në Kuvend. Pra, nga të gjithë të pranishmit pro, pa asnjë votë kundër, asnjë abstenim, kjo pikë shkon në Kuvend.

Si pikë e gjashtë e rendit të ditës:

**6. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031 të Komunës së Vitisë**

**z.Visar Demiri, drejtori:** Përshendetje për të gjithë të pranishmit! Para jush e keni propozim vendimit për miratimin e Planin Zhvillimor Komunal 2023-2031 të Komunës së Vitisë. Materialin e keni marrë me kohë të gjithë. Për ata që ju intereson më shumë jam i gatshëm që të bëj sqarime shtesë.

**z.Ilir Zuka:** Vetëm deshta me përshëndet drejtorin dhe Zyrën e Kryetarit për një punë të mirë dhe pse na zgjati pak, po me rëndësi ka ardhë dhe uroj që të implementohet të hy si duhet, se me të vërtet është dashtë të vijë më herët, por i dimë procedurat sepse është vonu.

**z.Jakup Demiri:** Unë si dokument që është kaq i rëndësishëm në këtë formë muaji dhjetor, sinqerisht me folë nuk e ka pas rendin me ardh, se ky e donë një analizë kogjo të thellë dhe tani e dimë se si e kemi situatën me festa me mërgimtarë dhe kjo pi ngjason me kalu me kontrabandu. Më së pari lista e kontribuesve qëtu i ke 90% që nuk e kanë dhanë asnjë pikë kontribut, tu u nis prej marrëveshjes që është marrëveshje mes Sokolit dhe UBT-së për interesa. Këtë e di sakt dhe shumë po më dhemb kur dokumentat e rëndësishme të vinë kështu.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Para se me nisë seanca i thashë Visarit, nëse kjo nuk ndryshohet në Kuvend nuk ta kaloj.

**z.Jakup Demiri:** Për me qenë më të sinqert, dokumenti më i rëndësishëm i komunës mos me na ardhë në dhjetor, se përime asnjë nuk kemi kohë me u marrë me këtë dokument. Tash veç ta kalojmë dhe ta kapërcejmë, sikur hartat zonale më herët që i kemi votu pa i lexu hiq.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Nuk i kemi votu hartat zonale, por marrëveshjen.

**z.Jakup Demiri:** Kemi votu dokument, i ka pas 70/80 faqe, aty na pa e lexu e kemi votu pjesën më të madhe të këtyre emrave. Unë kam fol, ka mi diskutu, ka emra këtu drejtor që as nuk e dinë që është tu ndodh ky sen a e ka emrin këtu e ky është mashtrim me fol drejt, ku u kan e udhës me marrë edhe opozitën dhe krejt dhe me i caktu njëjtë sikur edhe kontratën me memorandum bashkupnimi me atë, po veç paguj 70 mijë euro pa procedura të prokurimit hiq. (nuk dëgjohet) 0:59:20.

**Nënkryetari, z. Hasan Aliu:** Këta emra jan saktësisht që kanë kontribu, asnjë sun e hekë këtu ren ti njehi.

**z.Jakup Demiri:** Qe ku i ke 2 njerëz, Xhevdet Halilin kam bisedu.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Xhevdet Halili ka qenë me mu 3 ditë në Shqipëri.

**z.Jakup Demiri:** Ka ra ajo e Shqipërisë, se vitin e kalum ta kanë anulu.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Po nuk e kanë anulu, kan thanë me plotësu, ka kontribu.

**z.Jakup Demiri:** Ka kontribu, po kontributi i tij nuk është përfillë, se ka pas krejt tjetër sen.

**z.Visar Demiri, drejtori:** Kjo listë është bërë krejt në fillim, i kan marrë emrat që kanë dhanë kontribut. Nuk mundesh me thanë që nuk kanë dhanë, kanë qenë krejt të kyqt në plan dhe ata emra kanë mbet ne tu marrë me ministri shpeshhere për përmbajtjen nuk e kemi kqyr përbes, nuk e di a e kam kqyr ndonjëhere kështu se kam parë. U morra veshë që mu plotësu kjo që do të plotësohet kjo listë e kontribuesve dhe ka ikë kjo qështu se su marrë kush me ta. Kjo rregullohet për seancën. Sa i përkt listës së kontribusve, të gjithë ata që jan kanë kyq si Xhevdeti, si Albani që kanë dhanë një kohë kontribut jan të shënum aty.

**z.Ilir Zuka:** Këtë pjesën e emrave aty, në qoftë se janë cekë këta, unë e di shumë mirë që kanë qëndru 3 ditë në Shqipëri më shumë janë kanë të kyqt administratorët, d.m.th që u mbajtë në 4 lokacione që kanë qenë të kyqt, jemi kan se jemi merr me organizim e me njerëz. Pe dimë sa është problemi mi qitë njerzit, ata kanë bë punë, është mbajtë në Skifteraj, Pozheran, Smirë, Viti që ka qenë e përgjithshme, e pse mos me qenë dhe ata.

Nënkryetari, z.Hasan Aliu: Këta i kanë shti te aspektit profesional, prej ...
unë kam qenë trup koordinues. Ajeti ka qenë drejtor në atë kohë e ka trashegu Visari, Xhelal Haxhiu ka qenë i Urbanizmit, Xhevdet Halimi i planifikimit hapësinor, Granit Avdyli ka qenë prej bujqësisë, Arian Alidema ka qenë prej shëndetësisë në atë kohë, Alban Sokoli ka qenë si ekolog në atë kohë shumë ka kontribu, Kemur Mustafa i "Hidromoravës", ka qenë Kadri Ramadani, ka qenë shumë konstruktiv.

**z.Visar Demiri, drejtori:** Këto janë grupe punues prej secilit se plani është multi sektorial.

**z.Ilir Zuka:** Mua më erdhe shumë mirë që ka ardhë, po mos ti merremi me individuale, këtë prej UBT-s ne e kemi bërë organizmin ai e ka marrë krejt meritën.

**Nënkryetari z.Hasan Aliu:** Ti ke kontribu për me mbledh takimin në aspekt profesional kanë kontribu këtu.

**z.Ilir Zuka:** Ne nuk e kemi bërë vetëm tubimin, ai na ka vetë neve për zona për hapësira në bashkëbisedim ne nuk kemi qenë aty argat lloqi vetëm me bë tubim, ai me bë foto se në këtë mënyrë po e shpjegon ama nuk është ashtu.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë e pashë këtë shembull kryesus, Kuvendi Naim Pira ka qenë në atë kohë. Unë thashë duhet me hy shefat e grupeve që kanë marrë pjesë nëpër debate kanë qenë pjesë të grupit punues, se ky është dokument që mbet unë këtë e kërkova, nuk është vetëm Alia i shkruar. Dokumenti si dokument paraqet gjithpërfshirje.

**z.Ilir Zuka:** Pse mos me qenë edhe ata 4 administratorë që e kanë bë autorizimin.

**z.Visar Demiri, drejtori:** Lista e kontribusve lejohet edhe me u prekë, pasi kemi marrë pëlqimin në përmbajtje nuk është kjo, nëse e bëni një listë si kuvend se ju e miratoni shefat e grupave, kryesuesi nëse ka ndokush tjetër që e shofim e shtimë.

**z.Ramadan Deliu:** Unë kisha propozu administratorët me shti edhe kanë punu pa pare 4 vite kan nga ta kanë bë tubimin, të kanë mbledhë informata.

**z.Ilir Zuka:** Aty ku janë mbajt është mirë me u cekë.

**z.Jakup Demiri:** Nuk e kam për atë, por e kam për diçka tjetër. Edhe në takimin e Shqipërisë, njerëzit që e kanë kundershtu që kan ardhë aty nuk i kan senet korrekt edhe ajo që e ka kthy ministria.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Jakup, tek ai që po lidhesh, kurgja nuk ka thanë, ka tregu përralla, unë kam qenë aty as nuk ka fol për këtë punë as nuk u perqendru ai që ka dhanë kritikë në aspekt profesional që i kem shti gjithçka çka kem konsideru në aspekt profesional, ka qenë Alban Sokoli dhe nuk ka sen që nuk e kemi shti të tijë aty. Ai ka dalë me shitë men, nuk ka të bëjë fare me këtë punë hiq.

**z.Jakup Demiri:** Unë me qenë në vit të ri nuk ta bi nënkryetar.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Po nuk ta kam pru në vit të ri, në vitë të ri na e ka lëshu ministria. Jakup, qe ku e ke, e ka bë 35 mijë euro me pas qitë në ankand publik 100 mijë e kishe pagu këtë.

**z.Jakup Demiri:** 1 milion po të besoj po ja ka dhanë atij që e ka bë pazarin me të

**Nenkryetari z. Hasan Aliu:** Ja kemi dhanë atij që është më së liri.

**z.Visar Demiri, drejtori:** Komuna e Rahovecit e ka marrë pëlqimin për 1 ditë me neve prej ministrisë, ka organizu seanc të jashtëzakonshme dhe e ka marrë brenda 10 dite. Ne jemi tu shku në seancë të rregullt, kemi mëndu që është mjaftueshëm kohë se është seance e re. Ne me ja pas bë si Rahoveci tash ish kalu. Jemi në kohë besoj, tani mërgimtarët që do dikush me nejt me diasporë, se i vinë, ai është problem i tijë, por ne jemi besoj në kohë 1 muaj jan të mjaftueshme për me mujt me shqyrtu.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ne e dimë që ke pas debate publik, 3 kanë qenë, dhe unë që kam marrë pjesë. 1 muaj ka qenë debati, numri i kërkesav nuk e di sa ka qenë, sa janë përfill këto kërkesa. Po më intereson, sa janë parapa mundësia, se ne jemi tu i pa problemet, i kemi që sa kohë që na kthen vendimet e joligjshme ose e kemi hupë atë shtëpi për persona me nevoja të veçanta, për shkak se nuk e kemi pas planin zhvillimor sa kemi parpa. A kemi parpa edhe shtëpia për persona me aftësi të kufizuar, a kemi parapa varreza nëpër katune, ne nuk jemi shumë profesional, ne nuk marrim shumë vesh në këtë planin zhvillimor. Unë Veren e kaluar e kam udhëheq grupin për demografi, se atëhere ka qenë formë tjetër, unë një pjesë pak a shumë e kam pas një përovoj, por megjithatë prapë një pjesë nuk po e marrë vesh se nuk është lëmi e jemja.

**z.Visar Demiri, drejtori:** Shqyrtimi publik ka zgjatë 1 muaj, prej tyre qytetarët i kanë pas 3 mundësi. 1 me shkru në fletore, ka nejt te shtëpia kulturës përmes e-mailit dhe përmes protokollit kanë dërgu kërkesa diku kanë qenë mbi 70 kerkesa, 41 prej tyre komisioni i ka parapa që mund mu përfshi në plan zhvillimor komunal edhe të tjerat kryesisht nuk kanë pas të bëjnë me PZHK-në, por qytetarët nuk e kanë kuptu, ndoshta dhe ato nuk janë përfshi hiq prej tyre 41 janë pranu, 2 kanë ardhë pas afatit i kemi futë në rpaort dhe i kemi

dërgu në ministri, por e kemi shkru që kanë ardh pas afatit ata kan [illegible] përgjigje të gjithë për ata që marrë pëlqimin dhe prej minisrisë së atyre tjerave, i kemi obligim me ju kthy përgjigje të gjithë për ata që kemi adresë, se ka njerëz që kanë shkru në fletore anonime iniciale etj. Do ju japim arsye se pse u futë dhe pse nuk është marrë parasysh.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Këto 41 kërkesa që ju kanë dërgu ministrisë, a jan pranu?

**z.Visar Demiri, drejtor:** Po, janë pranu prej ministrisë. Këto janë të përfshim në plan zhvillimor. Ju edhe hartat i keni krejt, por problemi është që programi është asisoji, hartata që nuk i shikon mirë, përndryshe pëlqimin e ministrisë për vlerësim mjedisor e kemi marrë pjesa grafike jemi në rregull. D.m.th në aspektin ligjor jemi në rregull, se ministria për atë edhe nuk e lëshon. Nuk është përfekt, por ndoshta është më i mirë që deri tani kemi pas mundësi njerëzit me pas kërkesa të ndryshme.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Sa na cenon ky plani zhivllimor, tani që e miratojmë ne, përderisa të bëhet harta zonale. D.m.th a na bënë një ndërprerje të preocesit të këkresave të njerëzve për ndërtime ose investime a mësim pezull e kesja periudhës apo është në zbatim plani i vjetër deri sa të miratohet harta zonale.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Pëlqimin e ministrisë besoj e keni marrë në meterial, do të thotë që kushtet ndërtimore mos umë qojmë. Do të thotë kushtet ndërtimore deri në hartimin e hartave zonale nuk mundemi më me leshu, kështu që i bjen përveç dy lagjeve në tri pjesë të qytetit që kemi plan rregullues mujm me lëshu leje ndertimore, e per harta zonale ligji e parasheh që nuk mundem të miratohen 9 muaj pasi të miratohet PZHK-ja.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** E këta që janë në proces se kërkesës per leje dhe tash e miratojmë planin na a vazhdon procesi per këta.

**z.Visar Demiri, drejtor:** Po për këta vazhdon procesi.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që kjo pikë të shkon për në Kuvend me ngritej dore. Nga të gjithë të pranishmit u miratua kjo pikë e rendit të dites.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**
**Bekim Azizi**

_____________

**Procesmbajtësi:**
**Fatlum Demiri**

_____________

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA
Data/Datum: 09-01-2024
Nr. Organit / Org. broj: 02 | Numri/Broj: 035 | Shtojcë/Prilog: 02 | Vlera/Vrednost: 14

**Republika e Kosovë**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Vitisë**
**Opstina Vitina**
**Municipalty of Viti**

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2, pika d e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008, nenit 30, paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kryesuesi i Kuvendit propozon këtë:

## PROPOZIM VENDIM
## Për caktimin e orarit të mbajtjes së takimeve të kuvendit të komunës së Vitisë për vitin 2024

### Neni 1
Me këtë propozim Vendim, propozojmë që takimet e rregullta të Kuvendit të Komunës së Vitisë, në vitin 2024, të mbahen si vijon:

| Muaji | Takimet e Kuvendit të Komunës (Data) | Takimet e Komitetit për Politikë dhe Financa (Data) |
|---|---|---|
| Janar | 30.01.2024 | 22.01.2024 |
| Shkurt | 29.02.2024 | 19.02.2024 |
| Mars | 29.03.2024 | 22.03.2024 |
| Prill | 30.04.2024 | 22.04.2024 |
| Maj | 31.05.2024 | 22.05.2024 |
| Qershor | 28.06.2024 | 20.06.2024 |
| Korrik | 31.07.2024 | 22.07.2024 |
| Gusht | Pushim | Pushim |
| Shtator | 30.09.2024 | 23.09.2024 |
| Tetor | 31.10.2024 | 24.10.2024 |
| Nëntor | 28.11.2024 | 20.11.2024 |
| Dhjetor | 27.12.2024 | 18.12.2024 |

### Neni 2
Kuvendi sipas nevojës mbanë edhe mbledhje tjera të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

### Neni 3
Seancat solemne të Kuvendit do të jenë, si në vijim :
- 17 shkurti – Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës;
- 5 Maj - Dita e Dëshmorëve të Komunës së Vitisë;
- 14 Qershor – Dita e Çlirimit të Komunës së Vitisë.

### Neni 4
Mbledhjet e Komitetit për Politik dhe Financa do të mbahen njëherë në muaj, gjegjësisht 7 (shtatë) ditë para mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

### Neni 5
Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës

**P.S. Orari i mbledhjeve mund të ndryshoj për arsye të ndryshme.**

**Kryesuesi i Kuvendit**
**Bekim Azizi**

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 02 | 035 | 02 | 52 |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Bazuar në nenin 58 shkronja h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës ( Gazeta zyrtare nr 28/2008), Ligji për Zonat Ekonomike, neni 10 të Udhëzimit Administrativ (MTI) nr. 03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave te zonave ekonomike, nenit 50 shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë me numër 013/491 të datës 21.04.201, Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

# PROPOZIM VENDIM

**Për formimin e komisionit vlerësues për shqyrtimin e dokumentacioneve për vendosjen e bizneseve në Parkun Industrial në Budrik të Epërme**

## Neni 1
## Përbërja e Komisionit

Kryetari i Komunës i PROPOZON Kuvendit të Komunës së Vitisë të formon komisionin vlerësues për shqyrtimin e dokumentacioneve të pranuara nga bizneset afariste të cilat do të aplikojnë sipas konkursit publik për tu vendosur ne Parkun Industrial ne Budrik të Epërme

Komisioni ka këtë përbërje:

1. Burim Sadiku, nga ekzekutivi i komunës, kryesues
2. Ganimete Emini nga ekzekutivi i komunës, anëtare
3. ............................ nga Kuvendi i komunës, anëtar
4. ............................nga kuvendi i komunës , anëtar
5. Tefik Salihu, nga shoqëria civile, anëtar

## Neni 2
## Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të komisioni është i përkohshëm vetëm për konkursin publik për vendosjen e bizneseve Parkun Industrial ne Budrik të Epërm dhe brenda mandatit të kuvendit të komunës.

## Neni 3
## Detyra dhe përgjegjësit e komisionit

Komisioni ka për detyre dhe përgjegjësi të bëjë shqyrtimi e dokumentacioneve të pranuara nga bizneset afariste të cilat do të aplikojnë sipas konkursit publik për tu vendosur ne Parkun Industrial ne Budrik të Epërme, konform procedurave dhe kritereve të përcaktuara me dispozitat e ligjit për Zonat Ekonomike dhe Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 03/2014, për procedurën formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave te zonave ekonomike, kriteret e përcaktuara në konkursin publik si dhe ne dispozitat e tjera ligjore përkatëse.

## Neni 4
## Punët administrative – juridike të komisionit

Komisioni ne realizimin e detyrave të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore dhe me këtë propozim vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvilli.

## Neni 5

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues: Kryetari i Komunës, Sokol Haliti

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

| Pranuar - Primljeno Më/Dana 09-01-2024 vit.god. | | | |
|---|---|---|---|
| Nr.i organit Org.broj | Numri/Broj | Shtojcë Prilog | Vlera Vrednost |
| 02 | -035 | /02 | -15 |

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 58, paragrafi 1, shkronja h) e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 50.1, shkronja l) të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

# PROPOZIM VENDIM

## Për aprovimin e Planit të Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2024

**Neni 1**

Kryetari i Komunës, i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që ta shqyrtoj dhe aprovoj Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2024.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi, është Plani i Punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2024, me nr të protokollit 02-052/03-1477 i datës 12.12.2023

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij propozim vendimi për Planin e Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2024, kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë.

**Neni 4**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues:

Kryetari i Komunës
Sokol Haliti

Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA

12-12-2023

02-052/03-1477

Komuna e Vitisë

Opstina Vitina

Municipality of Vitia

# Plani i punës për vitin 2024

## Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi ( KKSB )

Viti, Dhjetor 2023

| Nr. rendor | Objektivat | Aktivitetet | Bartesit e aktiviteteve | Rezultatet e pritura | Afati kohor për kryerjen e aktiviteteve | Buxheti ( burimet financiare) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **1.**Bashkërendimi i iniciativave të përbashkëta të mekanizmave institucional për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në cdo bashkësi | **1.1** shqyrtimi dhe lstimi i aktiviteteve të përbashkëta të përcaktuara në planin e punës | Anëtarët e KKSB | -Ndërmirren iniciativa të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve për siguri në bashkësi | Janar | Nuk ka implikime buxhetore |
| 2 | **2.** Sensibilizimi i qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, identifikimi i brengave lidhur me sigurinë publike | **2.1** Organizimi i dy takimeve publike me qytetarë të komunës së Vitise ( session informues rreth rolit të KKSB-së dhe identifikimi i brengave të qytetarëve rreth sigurisë publike) | Anëtarët e KKSB | -Rritet vetëdijësimi i qytetarëve për natyrën e krimeve<br>-Identifikohen brengat e qytetarëve për sigurinë publike | Prill<br>Shtator | Nuk ka implikime buxhetore |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | **3.** Rritja e bashkepunimit të mekanizmave institucional që punojnë në fushën e sigurisë publike | **3.1**Mbajtja e takimeve të rregullta ndër institucionale dhe ndër komunale : KKSB-EVSK-KLSB, të tjerë | Anëtarët e KKSB, EVSK, KLSB | --Shkembehen përvoja për fushën e sigurisë publike | Në vazhdimësi | Buxheti komunal, donacione |
| 4 | **4.**Garantimi gjithëpërfshirës dhe pjesëmarrës i qytetarëve në forumet e sigurisë ( KKSB, EVSB, KLSB) përfshirë shoqërinë civile në adresimin adekuat të nevojave nga institucionet | **4.1**Mbajtja e takimeve të forumeve të sigurisë ( KKSB, EVSB, KLSB), me qytetarë | Anëtarët e KKSB, EVSK, KLSB | - Rritet pjesëmarrja e qytetarëve në forumet e sigurisë | Në vazhdimësi | Buxheti komunal, donacione |
| **5.** | **5.**Puna e Policisë së Kosovës të bazohet në planin e Policimit në Bashkësi | **5.1** Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Policimit në Bashkësi | PK | -Policia është e trajnuar dhe është rritur kualiteti në komunikim dhe parandalim të krimeve | Janar– Dhjetor | Buxheti MPB |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | **5.2** Policia e Kosovës ushtron kontroll më të rreptë të trafikut rrugor për të zvogluar aksidentet me fatalitet<br><br>**5.3** Policia e Kosovës ndërmerr operacione të vecanta si dhe organizon fushata vetëdijësuese së bashku me EVSB dhe KLSB për të zvogëluar | PK | -Zvogelohen incidentet me fatallitet<br><br>-Ulet përdorimi dhe armëmbajtja pa leje | Janar - Dhjetor | Ky plan nuk bart kosto financiare për këtë aktivitet | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | armëmbajtjet pa leje dhe gjuajtjet me armë | **PK, EVSB, KLSP** | | Janar-Dhjetor | |
| **6.** Siguria në shkollat e komunës së Vitisë | **6.1** Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimi i Planit operativ për siguri në shkolla | PK, DKA | -Zvoglohen incidentet në mes të nxënësve(grupmosha minorene) | Në vazhdimësi | Nuk ka implikime buxhetore |
| | **6.2** Policia e Kosovës zbaton planin operativ për siguri në shkolla dhe bashkëpunon ngushtë me institucionet e arsimit, këshillin e prindërve dhe të nxënësve duke mbajtur kontakte të rregullta | DKA, PK, Këshilli I prindve, Këshilli I nxënsve | | | |
| | 6.3 Funksionalizohen ekipet për siguri në shkolla | | | Në vazhdimësi | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 7.Siguria e nxënësve në trafik | **7.1** Patrullimi I rregullt i policisë gjatë orareve të shkuarjes në shkollë dhe daljes nga shkolla (me këtë orar ora 7.30-8.00, 12-13, 18-19) | PK | -Rritet siguria e nxënësve në trafik | Në vazhdimësi | Nuk ka implikime buxhetore |
| | **7.2** Raportimi statistikor i PK në baza periodike për situatën e sigurisë publike, nivelin e krimit dhe të rreziqeve | PK | -Organet kompetente mbajnë në shkallë të lartë komunikimin dhe ka informacion të mjaftueshëm dhe qytetarët kuptojnë drejt kërcënimet dhe sfidat reale | Raport tremujor, gjashtëmujor dhe vjetor | Nuk ka implikime buxhetore |
| 8.Sensibilizimi i të rinjëve për mbrojtje nga dukuritë që dëmtojnë shëndetin dhe zhvillimin e tyre potencial, rreziku nga përdorimi i narkotikëve | **8.1** Organizimi i ligjëratave në shkollat e mesme të komunës së Vitisë, për rrezikun nga përdorimi i narkotikëve | QKMF,QPS, PK, DKA | -Rritet vetëdijësimi i të rinjëve për rreziqet që sjell perdorimi i narkotikëve | | |
| | **8.2** Trajnimet e zyrtarëve që merren me aktivitete parandaluese të kësaj dukurie | | | Mars | |
| 9. Vetëdijësimi I të rinjëve për mbrojtje nga Trafikimi me qenie njerëzore dhe | 9.1 Organizimi i fushatës " mbrohu nga trafikimi me | | -Të rinjët mbrohen nga dukuritë negative | | Buxheti komunal<br>200€ |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| varësia nga mediat elektronike | qenie njerëzore” ( ligjërata në dy shkollat e mesme të Komunës së Vitisë) | PK,QPS, Drejtoria e Arsimit | | Tetor | |
| | 9.2 Vetëdijësimi I të rinjëve për mos keqpërdorimin e rrjeve sociale | | | | Buxheti komunal<br>200€ |
| 10. Shënimi I javës për viktimat e krimit | 10.1 Organizimi I aktiviteteve vetëdijësuese për të drejtat e viktimave të krimit | Komuna, PK, EVSB | Viktimat e krimit njoftohen për realizimin e të drejtave të tyre | Shtator | |
| 11. Parandalimi i dhunës në familje | **11.1** Takime te rregullta dymojore të Mekanizmit kunder dhunës në familje<br>**11.2** Zbatimi i Strategjisë Nacionale dhe Komunale për Parandalimin e Dhunës në Familje | MKKDHF | Zvoglohen rastet e dhunës në familje | Në vazhdimësi | Buxheti komunal<br>150€ |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 12. Parandalimi dhe luftimi i prerjes ilegale te pyjeve dhe mbrojtja e pyjeve nga zjarret | **12.1** Shpërndarja e fletëpalosjeve për sensibilizimin e qytetarëve për rëndësinë dhe ruajtjen e pyjeve dhe angazhimi i Njësisë Zjarrifikëse në raste intervenimi | Drejtoria e Bujqësisë dhe Pylltarise, KKSB, Njësia Zjarrëfikëse, PK | -Rritet vetëdijësimi I qytetarëve për të mbrojtur pyjet | Qershor, Korrik, Gusht | Buxheti komunal, donatorë |
